

UDHËZIM
Nr.34, datë 6.10.2010

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.24, DATË 2.9.2008 “PËR
PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Paragrafi i dytë i pikës 75/1.4, nga “Në rast se tatimpaguesi në administratën tatimore rezulton.....” deri në fund të pikës 75/1.4, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode